



MARREVESHJE PER SHITJEN E PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTAR

Sot ne daten 31/10/2005, ne Tirane lidhet kjo marreveshje midis paleve kontraktuese: para meje Noteres ERIKETA KOKOLI

Z. Adrian Shehu, i biri i Ramizit, lindur ne Tirane me 11/08/1961, dhe banues ne Tirane, Ortak i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Unioni Financiar Tirane" Sh.p.k. e regjistruar si e tille ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane me Vendimin Nr.9406, date 06/03/1995, (me poshte referuar si "Shitesi")

dhe

Z. Niko Leka, i biri i Vlashit, lindur ne Tirane me 31/03/1961, dhe banues ne Tirane, Ortak i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Unioni Financiar Tirane" Sh.p.k. e regjistruar si e tille ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane me Vendimin Nr.9406, date 06/03/1995, (me poshte referuar si "Bleresi")

Deklarimet Paraprake

- 1) Shitesi eshte Ortak ne shoqerine "Unioni Financiar Tirane" Sh.p.k. dhe zoteron 10% te kapitalit themeltar te saj. Shitesi ka vendosur shitjen e 5% te pjeseve te kapitalit themeltar qe zoteron tek Ortaku Niko Leka.
- 2) Mbledhja e Asamblese se Ortakeve te shoqerise "Unioni Financiar Tirane" Sh.p.k. miraton shitjen e pjeseve te kapitalit themeltar te zoteruara nga Adrian Shehu tek Niko Leka. (Shih Ankesin 1 te Marreveshjes)
- 3) Ne kushte te tilla, Bleresi pranon te bleje pjeset e kapitalit themeltar te ofruara nga Shitesi qe i korespondojne 5% te pjeseve te kapitalit themeltar qe zoteron Shitesi, duke zoteruar ne perfundim te ketij veprimi juridik 35% te pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise "Unioni Financiar Tirane" Sh.p.k.

Per sa me siper, ne baze te Nenit 198 dhe 204 te Ligjit Nr. 7638, date 19/11/1992 "Per Shoqerite Tregtare", palet bien dakord si me poshte:

f

[Signature]



Neni 1 - Objekti

- 1.1 Deklarimet Paraprake jane pjese perberese e kesaj Marreveshje.
- 1.2 Me anen e kesaj Marreveshje Shitesi i kalon Bleresit kundrejt shperblimit 5% te pjeseve te kapitalit themeltar qe ai zoteron ne kapitalin themeltar te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Unioni Financiar Tirane".

Neni 2 - Menyra e Pageses

- 2.1 Shitesi do te kryeje kalimin e pjeseve se kapitalit themeltar ne momentin e nenshkrimit te kesaj Marreveshje.
- 2.2 Bleresi do t'i paguaje Shitesit shumen prej Euro 291.028,00 (dyqindenenatedhjetenjemije njezetetete Euro) menjehere sapo te kryhet kalimi i pjeseve te kapitalit themeltar dhe gjithashtu merr pesiper te shlyeje per llogari te Shitesit 50% te detyrimeve qe Shitesi ka ndaj shoqerise Unioni Financiar Tirane deri ne momemntin e kalimit.
- 2.3 Pagesa do te kryhet me transferte bankare ne numrin e llogarise se Shitesit ose perpara Noterit.
- 2.4 Ne rast vonese Bleresi do te paguje nje kamate vonese prej 2% te shumes kontraktuale per cdo dite vonese.

Neni 3 - Garancite e Shitesit

- 3.1 Shitesi eshte pronari i vetem dhe me te drejta te plota te pjeses se kapitalit themeltar qe zoteron dhe nuk ekzistojne pretendime te paleve te treta ne lidhje me kete. Pjesa e kapitalit themeltar e zoteruar prej Shitesit eshte e lire nga cdo barre apo pretendim tjeter prej te treteve.
- 3.2 Pervec kesaj Marreveshje nuk egziston ndonje marreveshje tjeter e cila te detyroje Shitesin per kalimin, transferimin apo shitjen e kesaj pjese te kapitalit themeltar te zoteruar prej tij ndonje pale te trete.
- 

Neni 4 - Zgjidhja e mosmarreveshjeve

- 4.1 Kjo Marreveshje rregullohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.
4.2 Cdo mosmarreveshje ndermjet Paleve ne lidhje me kete Marreveshje do te zgjidhet nga Gjykata e Shkalles se Pare e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 5 - Gjuha e Marreveshjes

- 5.1 Kjo Marreveshje hartohet ne 3 (tre) kopje, ne gjuhen Shqipe, nga nje per secilen pale dhe nje mbahet nga Noteri.

Per SHITESIN


Per BLERESIN

ADRIAN SHEHU

Niko LEKA

Adrian Shehu

Niko Leke



ERIKETA KOKOLI

Kokoli